

# NDIKIMI KULTUROR NË KËRKIMIN E FALJES, PËRFAQËSIMI I KËTIJ AKTI KUMTUES NDËR SHQIPTARËT QË JETOJNË NË RMV

**Nertila RAMADANI<sup>1</sup>**

<sup>1</sup>Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Fakulteti Filologjik

<sup>\*2</sup>Corresponding author e-mail: nertila.sinani@unite.edu.mk

---

## Abstrakti

Studimi i pragmatikës dhe i disiplinave të veçanta po bëhet fenomen që zhvillohet në hulumtimet linguistike në nivel botëror. Gjuhëtarët dhe filozofët i konsiderojnë aktet e të folurit si një fenomen normal. Kohëve të fundit, gjithnjë e më shumë po bëhen kërkime se cilat akte të të folurit përdoren në komunikimin e përditshëm.

Aktet e të folurit dhe realizimi i tyre gjuhësor kushtëzohen nga faktori kulturor. Mënyra se si realizohen aktet e të folurit ndryshon nga një vend në tjetrin, nga një kulturë në tjetrën. Kështu, për shembull, nëse në botën perëndimore fjalët “pardon” ose “sorry” përdoren shpesh për aktin e kërkimit të faljes, në praktikën shqiptare këto shprehje nuk janë pjesë e jetës së përditshme. Në vend të kësaj, preferohet të përdoren fjalët shqipe, “më falni/ më fal”, “kërkoj falje/kërkoj ndjesë”, etj.

Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë përjasje teorike, empirike dhe statistikore të aktit kumtues – faljes, gjegjësisht të japim të dhëna më të qarta në lidhje me faktin se sa shpesh kërkohet falje, në çfarë mënyre, cilat fjalë dhe folje i përdorim gjatë kërkimit të faljes, a ekziston dallim gjinor në mënyrën e kërkimit të faljeve, si kërkohet falje të rinjtë kundrejt të moshuarve, a ndikon konteksti i ligjërimit dhe bashkëbiseduesi në aktin e faljes etj.

**Fjalët kyçe:** pragmatika, aktet e të folurit, falja, gjinia, moshë

---

## 1. Hyrje

Në dekadat e fundit, studimet gjuhësore janë orientuar drejt fushës së ligjërimit, akteve të të folurit dhe akteve specifike të gjuhës. Pragmatika po bëhet gjithnjë e më shumë një teori psikosociale, ndërsa studimi i akteve të të folurit është shndërruar në një nga sfidat më të fundit të studimeve gjuhësore të gjuhëve natyrore në mbarë botën. Kohët e fundit, aktet e të folurit janë studiuar gjithashtu si elemente që bëjnë dallime ndërkulturore dhe janë botuar një sërë punimesh që dallojnë akte të veçanta të të folurit midis dy gjuhëve, kulturave, vendeve.

Me këtë hulumtim do të mundohemi të japim një pasqyrë reale të aktit kumtues – faljes dhe përdorimin e tij ndër shqiptarët që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Pjesës praktike i paraprin aspekti teorik i fushës linguistike, e cila i studion këto dukuri gjuhësore gjegjësisht pragmatikës, teoria e akteve të të folurit, si dhe pjesa teorike rreth përkufizimit të faljes.

Hipotezat bazë të këtij punimi dalin nga pyetjet kryesore të hulumtimit tonë:

- Ekziston një ndryshim i vogël në mënyrën e kërkimit të faljes midis brezit të ri dhe atij të vjetër;
- Të rinjtë shqiptarë në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë mjaft kokëfortë dhe nuk kërkohet shpesh falje;

- Mundohen të kërkojnë falje në mënyrë implicite pa e “poshtëruar” veten para bashkëbiseduesit, duke përdorur fjalët “më falni”, “më fal”;
- Përfaqësueset e gjinisë femërore kërkojnë falje më shpesh në krahasim me gjininë e kundërt;
- Mënyra e kerkimit të faljes varet nga konteksti dhe nga bashkëbiseduesi.

Për të testuar hipotezat e mësipërme, kemi përdorur metoda cilësore dhe sasore për mbledhjen dhe analizën e të dhënave.

Nga metodat cilësore kemi përdorur analizën përshkruese, me të cilën jemi përpjekur të japim një përshkrim teorik të problemit që e hulumtojmë, si dhe një përshkrim të detajuar të termave që janë përdorur në punim. Përdorimi i kësaj metode ndihmon në nxjerrjen e konkluzioneve dhe përgjithësimeve të rezultateve të fituara nga hulumtimet e realizuara.

Mbledhja e të dhënave sasore u realizua nëpërmjet një ankete, e cila u realizua online me qëllim që të shkurtrohet kohëzgjatja, që të përfshihen sa më shumë pjesëmarrës, për të arritur në rezultate më të sakta.

## 1. Rreth termit pragmatikë dhe historia e shkurtër e pragmatikës

Pragmatika, si disiplinë moderne e studimeve gjuhësore buron nga filozofia e gjuhës. Rrënjët e saj filozofike mund të gjenden në veprat e filozofëve Charles Morris, Rudolph Carnap dhe Charles Peirce, të botuara në vitet 30’ të shekullit të kaluar. Si disiplinë gjuhësore, ajo u shfaq në kohën kur shtroheshin pyetjet: nga vjen gjuha (një sistem konventash)?; nga vjen kuptimi dhe lidhja e tij me referentin (por edhe përdorimi i tij nga folësi për qëllime të caktuara)? dhe nga vjen efektiviteti i disa akteve ligjore? (Rrokaj, Sh., 2015: 205-206).

Historia e pragmatikës dhe përdorimi i termit ‘pragmatikë’ lidhet me emrin e Charles Morris, i cili, i inkurajuar nga Peirce, u përpoq të vendoste themelet e shkencës së studimit të shenjave, semiotikës. Brenda semiotikës, ai dalloi tre drejtime kryesore: sintaksën, semantikën dhe pragmatikën (Huang, Y, 2015: 2).

## 2. Teoria e akteve të të folurit

Pragmatizmi anglo-amerikan është i lidhur ngushtë me filozofinë analitike, kryesisht me veprën e Austin dhe Searle mbi "aktet e të folurit". Plejada e studiuesve të Oksfordit, duke u mbështetur në parimet e Searle-it, e zhvilluan teorinë e akteve të të folurit. Austin bën pjesë në grupin e autorëve që ishin ndër të parët që pranuan se njerëzit nuk e përdorin gjuhën si të “izoluar”, por në përputhje me kontekstin e dhënë dhe me qëllim që të bëjnë diçka, gjegjësisht të veprojnë. Me fjalë të tjera, të folurit (ligjërimi) lidhet me përdorimin, veprimin, d.m.th. gjatë ligjëritimit folësi e realizon gjuhën ashtu si muzikanti që e realizon partiturën muzikore, ashtu siç piktori e pikturon vizatimin e tij.

Shkolla dhe drejtime të ndryshme pragmatike bëjnë klasifikime të veçanta të akteve të të folurit. Kështu, në librin e tij "Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme" Bugarski (Bugarski, R, 2004: 223-224) mbështetet në këtë klasifikim të akteve të të folurit: **asertivet** (dëshmimet - tipari më i rëndësishëm është e vërteta), **direktivët** (udhëzimet, urdhrat, me të cilat arrihet një efekt i caktuar), **komisivet** (premtime, kërcënime - me forcë detyruese në të ardhmen), **ekspresivet** (faljet, falënderimet, urimet - që tregojnë gjendjen psikologjike të folësit) dhe **deklarativët** (deklarata që shkaktojnë ndryshim të menjëhershëm të ndonjë gjendjeje).

Sipas klasifikimit të akteve të të folurit nga ana e Austin-it, kerkimi i faljes bën pjesë në kategorinë “mënyra e sjelljes”, së bashku me urimet, lëvdatat, ngushëllimet dhe sfidat, të cilat ai i

përkufizon si reagime të ngjashme me sjelljen personale dhe sjelljet kundrejt të tjerëve dhe janë të projektuara në atë mënyrë që të pasqyrojnë qëndrime dhe ndjenja.

## 2.1. Falja si akt i të folurit

Pjesa më e madhe e diskursit tonë moral privat dhe publik realizohet me dhënien, marrjen ose kërkimin e faljes, por rrallë mund të shpjegojmë se çfarë realisht presim nga ky akt. Si rezultat i kësaj, kërkimi i faljes bëhet një ritual gjithnjë e më i paqartë, i ngathët dhe nganjëherë edhe keqdashës.

Përcaktimi i aktit të të folurit - faljes varet nga disiplina kërkimore brenda së cilës analizohet. Në teorinë e akteve të të folurit, akti i kërkimit të faljes klasifikohet si "mënyrë sjelljeje" nga Austin dhe si "ekspresiv" nga Searle.

## 3. Pasqyrimi i rezultateve të anketës

Të dhënat për aktin e kërkimit të faljes të shqiptarët në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë edhe variablat: sa shpesh kërkojnë falje, si ndihen në momentin kur kërkojnë falje, a do të bënin diçka për ta shmangur këtë situatë, a varet kërkimi i faljes nga faktorë të tjerë dhe një sërë pyetjesh të ngjashme janë marrë nga anketa e realizuar online. Kjo anketë është realizuar në periudhën prej 29.03.2021 deri më 2.4.2021. Anketës iu përgjigjën në total 466 persona të moshave, gjinive dhe rajoneve të ndryshme.

Pyetja e parë që lidhej drejtpërdrejt me temën ishte: *A kërkonte falje?* Një numër i madh i të anketuarve, meshkuj dhe femra, të të gjitha moshave, janë përgjigjur pa hezitim: **Po**. Një numër i vogël janë përgjigjur se kërkojnë falje rrallë, dhe pothuajse 2% janë përgjigjur se kurrë nuk kërkojnë falje.

Tabela nr. 1 A kërkonte falje?				
Mosha	Gjinia		N	%
15-30	Femër	Po	217	81.0%
		Rrallë	38	14.2%
		Jo	3	1.1%
		Missing   System	10	3.7%
	Mashkull	Po	55	78.6%
		Rrallë	11	15.7%
		Jo	1	1.4%
		Missing   System	3	4.3%
30-50	Femër	Po	59	84.3%
		Rrallë	11	15.7%
	Mashkull	Po	4	100.0%

Pyetja: Cilën nga shprehjet e mëposhtme e përdorni më shpesh kur kërkonte falje? u parashtrua për të parë se cilat folje përdoren kur kërkojmë falje dhe për të bërë ndonjë krahasim të mundshëm me individë nga vende të tjera. Sipas përgjigjeve, mund të konkludojmë se përveç trajtave të shqipes: "më fal" dhe "kërkoj falje", përdoret edhe folja angleze 'sorry' edhe atë më shumë nga brezi i ri. Termi francez 'pardon' nuk është edhe aq i përfaqësuar në komunikimin e

përditshëm mes shqiptarëve të RMV-së, në krahasim me shqipfolësit që jetojnë jashtë kufijve, të cilët përpos foljeve shqipe përdorin edhe folje të gjuhëve të huaja.

**Tabela nr. 2: Cilën nga shprehjet e mëposhtme e përdorni më shpesh kur kërkonti falje?**

Mosha	Gjinia		N	%
15-30	Femër	Më vjen keq	20	7.5%
		Më fal	219	81.7%
		Sorry	26	9.7%
		Pardon	1	0.4%
		Missing   System	2	0.7%
	Mashkull	Më vjen keq	4	5.7%
		Më fal	54	77.1%
Sorry		12	17.1%	
30-50	Femër	Më vjen keq	4	5.7%
		Më fal	55	78.6%
		Sorry	9	12.9%
		Pardon	1	1.4%
		Missing   System	1	1.4%
	Mashkull	Më vjen keq	1	25.0%
		Më fal	3	75.0%

Kërkimi i faljes, mbi të gjitha, është një fenomen psikologjik dhe jo të gjithë e përjetojnë njësoj. Disa skuqen, të tjerët fitojnë takikardi, ndërsa të tretët e thonë fjalën spontanisht, pa u menduar gjatë. Në tabelën nr.3 shpjegohet më detajisht se si reagojnë individët ndaj këtij akti:

**Tabela nr. 3: Si reagoni kur duhet të kërkonti falje? ½**

Mosha	Gjinia		N	%
15-30	Femër	Skuqem	88	32.8%
		Më mbushen sytë me lot	94	35.1%
		Më dridhen duart	43	16.0%
		Nuk kërkoj falje, mundohem të arsyetohem	11	4.1%
		Missing   System	32	11.9%
	Mashkull	Skuqem	21	30.0%
		Më mbushen sytë me lot	35	50.0%
		Më dridhen duart	6	8.6%
		Nuk kërkoj falje, mundohem të arsyetohem	3	4.3%
		Missing   System	5	7.1%
30-50	Femër	Skuqem	35	50.0%
		Më mbushen sytë me lot	8	11.4%
		Më dridhen duart	4	5.7%
		Nuk kërkoj falje, mundohem të arsyetohem	5	7.1%

	Missing	System	18	25.7%
Mashkull	Skuqem		2	50.0%
	Më dridhen duart		1	25.0%
	Missing	System	1	25.0%

Parë në aspekt gjinor, gjatë kërkimit të faljes, një numër më i madh i meshkujve (47%) janë përgjigjur se sytë e tyre mbushen me lot në krahasim me femrat (30%). Një përqindje pothuajse e barabartë janë përgjigjur se skuqen. Janë të pakta rastet e atyre që u dridhen duart ose që përpiqen ta tejkalojnë faljen, duke ia hedhur fajin bashkëbiseduesit.

<b>Tabela nr. 4: Si reagoni kur duhet të kërkoni falje?2/2</b>				
Gjinia		N	%	
Femër	Skuqem		123	36.4%
	Më mbushen sytë me lot		102	30.2%
	Më dridhen duart		47	13.9%
	Nuk kërkoj falje, mundohem të arsyetohem		16	4.7%
	Missin	System	50	14.8%
Mashkull	Skuqem		23	31.1%
	Më mbushen sytë me lot		35	47.3%
	Më dridhen duart		7	9.5%
	Nuk kërkoj falje, mundohem të arsyetohem		3	4.1%
	Missin	System	6	8.1%

Në pyetjen: Si ndiheni kur kërkoni falje?, numri më i madh (171 të anketuar) janë përgjigjur se janë penduar për gabimin, 156 se ndihen fajtorë, 50 kanë turp që kanë reaguar në një mënyrë specifike dhe 23 janë përgjigjur se kanë qenë të trishtuar.

<b>Tabela nr. 5: Si ndiheni kur kërkoni falje?</b>			
	N	%	
Ndjenja e fajësisë	171	41.5%	
Turp	50	12.1%	
Ndihem në faj	156	37.9%	
I/e mërzituar	23	5.6%	
Missing	System	12	2.9%

Pyetjes: Sa shpesh i përdorni shprehjet: *Më falni, gabimi im, nuk doja por...?*, mesatarisht janë përgjigjur se këto shprehje i përdorin në mënyrë mesatare (më falni - 2.73, më fal - 2.63, do të përpiqem ta rregulloj gabimin - 2.39 ...dhe më pak e përdorur është shprehja gabimi im - 2.18), që nënkupton që ose nuk kërkojnë falje aq shpesh, ose nuk krijojnë situata në të cilat duhet të kërkojnë falje apo nuk duan ta pranojnë fajin.

**Tabela nr. 6: Mesatarja e përdorimit të fjalëve me të cilat kërkohmë falje**

	N	Minimu m	Maximu m	Mean	Std. Deviation
Më vjen keq!	388	1	5	2.29	1.092
Ishte faji im!	384	1	5	2.18	1.128
Nuk doja, por...	382	1	5	2.32	1.205
Më fal!	394	1	5	2.63	1.026
Kërkoj falje!	379	1	5	2.73	1.402
Do të mundohem ta përmirësoj gabimin!	380	1	5	2.39	1.137
Valid N (listwise)	371				

Për të vërtetuar nëse kërkimi i faljes varet nga konteksti dhe nga bashkëbiseduesi, të anketuarit i vendosëm përballë 6 situatave të ndryshme, ndër të cilat bashkëbiseduesi është ndonjë i panjohur, profesor, anëtar i familjes së ngushtë: vëllai/motra, nëna, si dhe shoku më i ngushtë.

Në situatën nr.1, kërkohet të imagjinohej se ishin vonuar për në një ligjëratë të rëndësishme. Me të hyrë në derë, të gjithë sytë e të pranishmëve, përfshirë profesorin, janë kthyer nga dera. Pyetja ishte, si do të reagonit? Numri më i madh i rasteve janë përgjigjur se do të kërkonin falje dhe do të justifikoheshin, duke treguar arsyen pse u vonuan (arsyeja më e zakonshme lidhet me bllokimin e trafikut, mungesën e transportit publik, që në fakt janë arsye të shpeshta për vonesë), të tjerët vetëm kërkohmë falje dhe një numër më i vogël janë përgjigjur se do të niseshin për në vendin e tyre, pa shumë arsyetime.

Situata nr. 2 lidhet me vëllain/motrën. Vëllai/motra juaj po feston ditëlindjen dhe ju e keni harruar plotësisht datën. Çfarë do të bëni, si do ta rregulloni gabimin? Në këtë situatë, vihet re një rënie të lehtë e përdorimit të fjalës “më fal”. Shumica u përgjigjën se nuk i harrojnë kurrë këto raste, disa u përgjigjën se do ta kapërcenin situatën duke bërë shaka, duke premtuar se dhurata do të vijë brenda kohës, sepse “dyqani ishte mbyllur, dërgesa nuk erdhi, e harrova dhuratën në shtëpi etj”. Një numër i vogël i të anketuarve deklaruan se nuk blejnë kurrë dhurata dhe e urojnë njëritjetritin për ditëlindje duke u përqaftuar dhe duke i uruar vëllait/motrës çdo të mirë.

Situata nr.3 lidhet me ngjarjet e fundit dhe mënyrën e re të mësimdhënies, mësimdhënien elektronike. Gjatë ligjëratës, ndodh një gabim teknik dhe nuk mund ta dëgjoni profesorin. Si do të reagoni? Një numër i madh u përgjigjën se do të kërkonin falje dhe do t'i kërkonin profesorit të përsëriste edhe një herë atë që tha, ndërkaq një pjesë e konsiderueshme u përgjigjën se nuk do ta pyesnin drejtpërdrejt profesorin, por do të gjinden në mënyrë që do t'i pyesin më vonë kolegët, që vërtetohet se kontakti fizik, i drejtpërdrejtë luan rol të rëndësishëm gjatë kërkimit të faljes.

Nëna, pika e dobët e pothuajse çdo individ, ishte 'kryefjala' e situatës nr. 4. Nëse keni harruar të blini ilaçet e nevojshme për nënën tuaj, si do të reagonit? – ishte pyetja lidhur me situatën nr. 4. Gjysma e të anketuarve do të kërkonin falje dhe do të ktheheshin menjëherë për të korrigjuar gabimin. Pothuajse 90% janë përgjigjur se ndihen fajtorë, të shqetësuar, të trishtuar. Disa prej tyre janë përgjigjur se nuk i harrojnë kurrë mesazhet e nënave të tyre.

Situata nr. 5 pasqyron përdorimin më të shpeshtë të kërkimit të faljes. Ajo lidhet me një bashkëbisedues të panjohur. “Nëse jeni në një qytet të ri dhe nuk dini si të arrini në një vend të caktuar, pyesni një kalimtar për vendndodhjen. Si do ta pyesni?” Mbi 95% e të anketuarve janë përgjigjur se fillimisht do të kërkonin falje dhe më pas do ta pyesnin se ku është vendi.

Kur bëhet fjalë për situata të ndjeshme që kanë të bëjnë me shokun/shoqen, shqiptarët janë përgjigjur se janë të sjellshëm dhe kërkojnë falje. Situata nr. 6: Nëse shoku juaj ju thotë diçka shumë të rëndësishme, ndërsa ju nuk dëgjoni sepse jeni të përqendruar në telefon, si do të reagoni? Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve janë përgjigjur se do të kërkonin falje, por numri më i madh janë përgjigjur se nuk e shikojnë telefonin e tyre derisa shoku i tyre po u thotë diçka shumë të rëndësishme.

#### 4. Përfundim

Siç dihet, në të kaluarën rëndësi më e madhe i kushtohej formës standarde të gjuhës, si sistem shenjash. Kohëve të fundit të folurit, si akt individual, zë vendin e duhur në studimet gjuhësore. Në të njëjtën kohë, fokusi i studimeve më të reja është i orientuar drejt pragmatikës dhe akteve të të folurit. Nga anketa e realizuar mund të konstatojmë se akti kumtues – falja tek shqiptarët në Republikën e Maqedonisë së Veriut është gjerësisht i përfshirë, pa dallim gjinie, moshe apo vendbanimi. Mund të konstatojmë se këto shprehje përdoren tashmë në komunikimet rutinë të përditshme, pa u menduar shumë. Gjithashtu, mënyra e kërkimit të faljes varet nga konteksti i të folurit dhe nga bashkëbiseduesi. Kështu, të gjithë i kërkojnë falje një bashkëbiseduesi të panjohur apo më të vjetër, gjë që nuk ndodh me miqtë, vëllezërit/motrat, pra me të afërmit. Nga rezultatet e marra, vërejmë se shqiptarët preferojnë të përdorin format gjuhësore shqiptare të kërkimit të faljes në vend të atyre të huaja.

#### Bibliografia

- [1]. Andersen, G. (2001). *Pragmatic markers and sociolinguistic variation: A Relevance – theoretic approach to the language of adolescents*. John Benjamins Publishing company.
- [2]. Austin, J. L. (1962). *How to do things with words*. Oxford: Clarendon Press.
- [3]. Alston, W. S. (2000). *Illocutionary Acts and Sentence Meaning*. Ithaca: Cornell University Press
- [4]. Bach, K., & Harnish, R. M. (1982). *Linguistic Communication and Speech Acts*. The MIT Press.
- [5]. Ballmer, T., & Brennstuhl, W. (2011). *Speech Act Classification: A Study in the Lexical Analysis of English Speech Activity Verbs (Springer Series in Language and Communication, 8)* (Softcover reprint of the original 1st ed. 1981 ed.). Springer.
- [6]. Bugarski, R. (2003). *Jezici*. Biblioteka XX vek.
- [7]. Bugarski, R. (2004). *Uvod u opstu lingvistiku*. Biblioteka XX vek.
- [8]. Cruse, A. (2011). *Meaning in Language: An Introduction to Semantics and Pragmatics (Oxford Textbooks in Linguistics)* (3rd ed.). Oxford University Press, Usa.
- [9]. Cutting, J. (2002). *Pragmatics and Discourse: A Resource Book for Students (Routledge English Language Introductions)* (1st ed.). Routledge.
- [10]. Goffman, E. (1971). *Relations in Public: Microstudies of the Public Order*. Harmondsworth: Penguin.
- [11]. Grup autorësh (1975). *Fjalor i termave të gjuhësisë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- [12]. Huang, Y. (2015). *Pragmatics (Oxford Textbooks in Linguistics)* (2nd ed.). Oxford University Press.
- [13]. Leech, G. (1983). *Principles of Pragmatics (Longman Linguistics Library)* (1st ed.). Longman Group Limited.
- [14]. Levinson, S. C. (1983). *Pragmatics (Cambridge Textbooks in Linguistics)*. Cambridge University Press.
- [15]. Lloshi, Xh. (2012). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Albas.
- [16]. Milenkovska, S. (2018). Model na interpretacija na direktните i indirektните govorni činovi so primena na pragmatičkite teorii (vrz primeri od makedonskiot dramski diskurs). *Slavia Meridionalis*, 18. <https://doi.org/10.11649/sm.1665>
- [17]. Ogiemann, E. (2009). *On Apologising in Negative and Positive Politeness Cultures (Pragmatics & Beyond New Series)*. John Benjamins Publishing Company.
- [18]. Rrokaj, Sh. (2012). *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*. Arbëria.
- [19]. Rrokaj, Sh. (2015). *Filozofi e gjuhës*. Arbëria.
- [20]. Rrokaj, Sh. (2010). *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*. Arbëria.
- [21]. Searle, J. R. (1985). *Expression and Meaning*. Cambridge University Press.
- [22]. Searle, J. R. (1969) *Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language*. Cambridge University Press.
- [23]. Smith, N. (2008). *I Was Wrong: The Meanings of Apologies* (1st ed.). Cambridge University Press.